

22-03-2021

Ref. 2103/361/BA/yf



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.14/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/311/BA/yf/ të datës 11.03.201 të parashtruesit “TV Syri Vison” SH.P.K., të përfaqësuar nga Ardian Canhasi kundër Vendimit me numër Ref:2102/167/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar Ankesa e “TV Syri Vision” SH.P.K. me numër Ref:2102/311/BA/yf e datës 11.03.2021 kundër Vendimit të Komisionit të Pavarur të Mediave me numër Ref:2102/167/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 vetëm sa i përket shqiptimit të gjobës dy mijë (2000) euro, të zbritet në shumën një mijë (1000) euro, ndërsa pjesa tjetër e Vendimit mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/167/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 i ka shqiptuar gjobë në shumën dy mijë (2000) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 për shkelje të nenit 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr.033/L-037 për zgjedhje në Republikën e Kosovës.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “TV Syri Vision” SH.P.K. ka parashtruar Ankesë me Ref:2103/311/BA/yf të datës 11.03.201, të përfaqësuar nga Ardian Canhasi pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material dhe për shkelje procedurale dhe kërkon të anulohet Vendimi i KPM-së.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “TV Syri Vision” SH.P.K”, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës me të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/167/KPM/xh.l të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa edhe përkundër shkeljes së Palës ankuese në baze të Vendimit kontestues, për zvogëlimin e gjobës si në dispozitivin e këtij Vendimit ka vendosur për shkak të krizës financiare globale si pasojë e Covid 19, e cila krizë ka ndikuar edhe në fushën e mediave.

Andaj, Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të nicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:
-Palëve dhe
-Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa